



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 8PP/ Prot.  
6

Tiranë më 24.12.2021

VENDIM

Nr. 55, datë 20.12.2021

**“Për miratimin e nënfushës “Gjuhësi” në riorganizimin e programit të studimeve të doktoratës në “Shkenca Humane, Albanologjike dhe Gjeografike” në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të UT-së, për vitin akademik 2022-2023”**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 2/b; neni 35, pika 1; neni 38, pika 1/dh; neni 77 dhe neni 91, pika 3; VKM nr. 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar; Udhëzimin e MASR, nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, Kreu IV, gërma “E”; Udhëzimin e MASR, Nr. 10, datë 30.03.2020, “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, i ndryshuar, Kreu I, pika 2; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, gërmat “f” dhe “j”, Vendimin e Senatit Akademik të UT-së nr. 14, datë 26.04.2021 si dhe në propozimin e përcjellë nga Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë me shkresën Nr. 439/2 prot., datë 18.11.2021, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 20 / 12 / 2021,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë riorganizimin e programit të studimeve të doktoratës në “Shkenca Humane, Albanologjike dhe Gjeografike” (në fushën e shkencave humane sipas manualit të FRASCAT-it), në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, duke shtuar edhe nënfushën e mëposhtme:
  - “Gjuhësi”
2. Të miratojë formën e diplomës për programin e ciklit të tretë të studimeve të doktoratës në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të UT-së.
3. Dokumentacioni përkatës t’i përcillet për miratim Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
4. Pas miratimit të MAS, sipas pikës 3 të këtij vendimi, dokumentacioni përkatës të përcillet edhe në Qendrën e Shërbimeve Arsimore për regjistrimin e formës së diplomës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Artan Hoxha

